



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstvo Obrazovanja Nauka i Tehnologije - Ministry of Education, Science and Technology**

*Kabineti i Ministrit/ Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister*

Nr. 180/013

Datë: 27 prill 2015

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/I-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (*Gazeta zyrtare nr 82, 21 tetor 2010*), në nenin 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), si dhe duke u bazuar në Ligjin Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit dhe UA për procedurat administrative të inspektimit në institucionet edukativo-arsimore dhe shkencore, (nr. 11/2005, 4 prill 2005), nxjerr:

**Urdhëresë**

1. Urdhërohet Departamenti i Inspeksionit të Arsimit që në pajtim me Ligjin Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë (*neni 4, paragrafi (h) dhe (p)*), të ndërmarrë të gjitha veprimet konkrete për inspektim special të validitetit ligjor të diplomave të mësimdhënësve të dyshuar për falsifikim sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.nr.155/2009 dhe 505/2009 të dt. 24.03.2010 kundër 84 mësimdhënësve për vepër penale falsifikimin e dokumenteve zyrtare, përkatësisht, diplomave të falsifikuara në ish-SIILP "Bajram Curri" në Gjakovë.
2. Inspeksioni i Arsimit obligohet që brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më 22 maj 2015, të dorëzoj raportin zyrtar në të cilin konstaton gjendjen faktike dhe propozon masat për mënjanimin e lëshimeve dhe parregullsive eventuale.
3. Inspeksioni i Arsimit obligohet që në rast të konstatimit të lëshimeve dhe parregullsive, në pajtim me Ligjin Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë (*neni 5, paragrafi 5.3. (e) dhe paragrafi 5.4 (c)*) të marrë vendim të

menjëhershëm për iniciimin e procedurës adekuate sipas shkallës së cenimit të ligjit.

4. Në rast të parregullsive apo lëshimeve të Inspeksionit të Arsimit, përgjatë procesit të inspektimit, do të merren masat e përgjegjësive sipas Ligjin Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë (neni 6, paragrafi 6.1 (b), (c), (d), (e), (f)).
5. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Departamentit të Inspeksionit të Arsimit dhe Udhëheqësi i Sektorit të Inspeksionit të Arsimit në Gjakovë për zbatimin e kësaj urdhërese.
6. Kjo urdhëresë hyn në fuqi me nënshkrimin nga Ministri.

### Arsyetim

Me dt. 24 mars 2010, Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritur aktakuzë PP.nr.155/2009 dhe 505/2009 kundër 84 mësimeve për vepër penale falsifikimin e dokumenteve zyrtare.

Me dt. 16 dhjetor 2010, Sektori i Inspeksionit të Arsimit ka pranuar njoftimin me memorandum zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme në Pejë, NjRIIKEK, DHKEK/DPP, me nr. referencës: 238/2010, ku është njoftuar për listën e personave (mësimeve) të Komunës së Malishevës dhe Komunës së Rahovecit, ndaj të cilëve është ngritur kallëzim penal (me dt. 16.11.2009; 05.05.2010; 16.11.2009; 23.12.2009 dhe 10.03.2010).

Me dt. 26 shkurt 2014, Gjykata Themelore në Gjakovë, ka nxjerr aktvendimin P. nr. 108/2014, ku ka hudhur poshtë aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe ka pushuar procedurën penale kundër të akuzuarve për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Me dt. 15 prill 2015, me shkresën nr. 216, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka pranuar njoftimin nga Udhëheqës i Sektorit të Inspeksionit të Arsimit në Gjakovë për dokumentacionin lidhur me validitetin e diplomave të mësimeve të dyshuar për falsifikim, të akuzuar nga Prokuroria dhe të liruar nga Gjykata Themelore në Gjakovë.

Prof. dr. Arsim Bajrami, ministër



The image shows a circular official stamp of the Ministry of Education, Science and Technology of Kosovo. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVES' at the top, 'SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË' in the middle, and 'MINISTRI I ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË' at the bottom. Below the stamp is a handwritten signature in blue ink.

**Urdhëresa ju dërgohet:**

1. Kabinetit të Ministrit;
2. Sekretarit të Përgjithshëm;
3. Departamentit të Inspeksionit të Arsimit;
4. Sektorit të Inspeksionit të Arsimit në Gjakovë;
5. Departamentit për zhvillimin e arsimit parauniversitar;
6. Departamentit për politikat e arsimit parauniversitar;
7. Departamentit Ligjor;
6. Arkivit të MASHT.